

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Informacion i Përgjithshëm

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a (ose “Shoqëria”) ka objekt kryesor të aktivitetit shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Shoqëria është krijuar më datë 28 Mars 2018 si shoqëri e kontrolluar nga Shoqëria mëmë - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ShA (OSHEE).

Shoqëria u krijua në zbatim të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me qëllim ndarjen e aktivitetit të shërbimit universal të furnizimit për klientët e tregut të rregulluar, nga aktiviteti i shpërndarjes dhe aktiviteti i shitjes në tregun e lirë të energjisë elektrike.

Për këtë, bazuar në vendimin e Asamblesë së OSHEE ShA nr.458 dt.15.2.2017 “Për aprovimin e modelit të korporatës”, Ministri i MIE, me urdhërin nr.157 dt.12.2.2018, urdhëroi krijimin e tre shoqërive, ndër ta, krijimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

Kapital themetar i shoqërisë është në vlerën 3.5 mln lekë i ndarë në 3,500 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1,000 lekë secila, të cilat zotërohen 100% nga Shoqëria Mëmë. Funksionet e përfaqësuesit të aksionerit për shoqërinë ushtrohen nga Administratori i OSHEE ShA

Sistemi i administrimit të shoqërisë është me një nivel.

Administrator nga data 31.12.2019 e në vazhdim është z.Petra Lika, duke zëvendësuar z.Malond Druga i cili mbante detyrën e Administratorit nga data 28 Mars 2018. Këshilli i administrimit është i përbërë nga tre persona dhe drejtohet nga Kryetari z.Përparim Nebiaj nga data 20.12.2019, duke zëvendësuar z.Petra Lika i cili mbante këtë detyrë nga data 28 Mars 2018.

Shoqëria është rregjistruar në QKB më datë 30 Mars 2018.

Me vendimin nr.216 dt.11.10.2018, ERE vendosi transferimin e licencës së Operimit e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të OSHEE tek OSSH.

Por, duke vlerësuar ecurinë e procesit të ndarjes së aktivitetit të shoqërisë OSHEE ShA e të konsolidimit të shoqërive të krijuara, si dhe plotësimin e nevojshëm me aktet ligjore e nënligjore, me propozim të aksionerit, ERE me vendimin nr.264 dt.20.12.2018, vendosi që licenca të bëhet efektive pas një periudhe tranzitore prej 12 muaj, duke saktësuar se gjatë kësaj periudhe, veprimtaria e shpërndarjes së energjisë elektrike, do të vazhdojë të kryhet nga OSHEE ShA. Periudha tranzitore është shtyrë deri më 31.12.2019 me Vendimin e ERE nr.211 dt.18.12.2019.

Aksionari i shoqërisë, me vendimin e datës 24.12.2019, ka vendosur që shoqëria të kryejë të gjitha veprimet/operacionet si subjekt i veçantë nga strukturat e OSHEE SHA.

Kështu, nga data 1 Janar 2020, shoqëria do të ushtrojë normalisht aktivitetin me të gjitha të drejtat operacionale dhe kontraktore si subjekt juridik, sipas licensimit dhe akteve ligjore në fuqi.

Në periudhën raportuese, shoqëria nuk ka ushtruar aktivitet biznesi, blerje e shitje, por ka paguar detyrimet për paga e sigurime për Administratorin dhe pagesat për Këshillin e Administrimit, ka paguar tarifat për licensimin dhe taksat vendore, shpenzime këto bazë për përgatitjen e fillimit të aktivitetit.

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

Në periudhën raportuese, shoqëria ka bërë përgatitjet e kuadrit ligjor dhe funksional për të konsoliduar proceset e punës dhe strukturat organizative për momentin e fillimit të veprimtarisë operuese.

Shoqëria është licensuar nga ERE në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike - vendimi nr.198 dt.3.9.2018 dhe në veprimtarinë Furnizimit të Energjisë Elektrike - vendimi nr.199 dt.3.9.2018.

Shoqëria e ka vendndodhjen në Shqipëri. Adresa kryesore e shoqërisë është në : Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88,H.1, Kati V, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë (adresa e regjistruar në QKR).

2. Politikat e kontabilitetit

Përgatitja e Pasqyrave Financiare, në të gjitha aspektet materiale, është bërë në përputhje me Statndartet Ndërkombëtre të Kontabilitetit (SKN) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të cilat janë lëshuar nga Bordi i Standardeve të Kontabilitetit (BSNK) dhe shpallur për zbatim nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

2.1 Standardet e kontabilitetit

Janë efektive në periudhën raportuese, ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), megjithëse miratimi i tyre nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të shoqërisë :

- Ndryshimet ne SNRF 3 “Kombinimet e Biznesit”, efektive në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 ;
- Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet financiare", mbi Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ, efektive në periudhat vjetore që fillojnë më/pas datës 1 Janar 2019 ;
- Ndryshimet ne SNRF 11 “Marrëveshjet e Përbashkëta”, efektive në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 ;
- Ndryshimet ne SNK 12 “Tatimi mbi të Ardhurat”, efektive në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 ;
- Ndryshime në SNRF 15 “Të ardhurat nga Kontratat me Klientët”, efektive per periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2019 ;
- Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë", efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më datë 1 Janar 2019 ;
- Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2015-2017)" që rezultojnë nga përmirësimi i përvitshëm të projektit të SNRF (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllimin që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019) ;
- Ndryshimet ne SNK 23 “Kostot e Huamarrjes”, efektive në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 ;
- Ndryshimet ne SNK 28 “Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta”, efektive në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 ;
- Ndryshimet në KIRFN 23 “Paqartësi mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat”, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

Ende nuk janë efektive në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet e tyre, të cilat shoqëria ka zgjedhur të mos i adoptojë pasi parashikon se nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre :

- Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe do të zbatohet në prospektivë ;
- Ndryshimet në SNK 8 “Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet”, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe do të zbatohet në prospektivë ;
- Ndryshimet në SNKF 10 “Ngjarje pas periudhës së aportimit”, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe do të zbatohet në prospektivë ;
- Ndryshimet në SNK 34 “Raportimi financiar i ndërmjetëm”, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe do të zbatohet në prospektivë ;
- Ndryshimet në SNK 37 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara”, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe do të zbatohet në prospektivë ;
- Ndryshimet në SNRF 3 “Kombinimet e biznesi”, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 ;
- Ndryshimet në SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit”, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021 ;
- Ndryshimet të “Kudrit Konceptual për Raportimin Financiarë të 2010”, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 ;
- Ndryshimet të “Kudrit Konceptual për Raportimin Financiarë të 2018”, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020.

2.2 Vlerësimet

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, Drejtimi i ka bërë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve si dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në datën e raportimit të pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve. Shpjegimi i supozimeve kyçe është përfshirë në seksionet përkatëse të shënimeve, aty ku janë përshkruar vlerësimet domethënëse.

2.3 Këmbimi i valutës së huaj

(a) Monedha funksionale dhe ajo e raportimit

Pasqyrat financiare janë paraqitur në LEK e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë. I gjithë informacioni financiar i pasqyruar në LEK është i përafëruar në njëshen më të afërt (nëse nuk është shprehur ndryshe).

(b) Kursi i këmbimit valutor në fund të periudhës raportuese (për monedhat kryesore):

Monedha	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
LEKË për 1 EUR	121.77	123.42
LEKË për 1 USD	108.64	107.82

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

2.4 Aktivet Afatgjata Materiale

Shoqëria nuk ka aktive afatgjata materiale, të evidentuara në periudhën raportuese.

Aktivet Financiare, Aktivet Jofinanciare, Inventarët, Instrumentat financiare

Shoqëria nuk të rregjistruar gjatë periudhës raportuese dhe në balancën e mbylljes, Aktivet Financiare, Aktivet Jofinanciare, Instrumentat financiare dhe Inventar.

Për këtë nuk mund të shprehemi për vlerësim, zhvlerësim apo rënie në vlerë.

Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga Interesi mbi gjëndjen e fondeve në bankë dhe fitimet nga kursi i kembimit i njohur në Pasqyrën e të Ardhurave. Të ardhurat nga Interesi njihen në vazhdimësi. Shpenzimet financiare përbëhen nga shpenzimi i interesit të huave si dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë i të ardhurave

Shpenzimet tatimore përbëhen nga tatimi aktual dhe ai i shtyrë. Shpenzimet tatimore njihen në Pasqyrën e të Ardhurave, përveçse kur lidhen me zëra të njohur drejtpërdrejtë në kapital dhe në një rast të tillë ato njihen si pjesë kapitali.

Manaxhimi vlerëson në mënyrë periodike pozicionet e marra në deklaratimet e tatimit mbi fitimin, duke marrë parasysh situatat në të cilat rregulloret e aplikueshme tatimore janë subjekt i interpretimeve dhe aty ku është e përshtatshme, krijon Provigjionet përkatëse.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose të miratuara në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke marrë parasysh diferenca të përkohshme ndërmjet vlerësneto kontabël në bilanc të një aktivi ose pasivi për qëllime të raportimit financiar dhe bazës së tij tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen në diferencat e përkohshme, kur ato të kthehen mbrapsht, në bazë të ligjeve që janë nxjerrë ose miratuar në datën e raportimit.

Vlerat e drejta

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një instrument financiar mund të shkëmbehet në një transaksion në mes dy palëve të gatshme, përveç se në rastin e një shitjeje të detyruar ose të likuidimit të menjëhershëm, dhe është përcaktuar më së miri nga një çmim tregu.

3.5 Menaxhimi i Kapitalit

Kur flitet për menaxhimin e kapitalit objektivat e kompanisë janë të tilla për të ruajtur një vazhdueshmëri normale të aktivitetit në mënyrë që të sigurohen fitime për Aksionerët dhe përfitime për palët e Interesuara si edhe për të mbajtur një strukturë optimale kapitali në mënyrë që të reduktohet sa më

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

shumë kosto e kapitalit.

Të dhënat për kapitalin dhe strukturën e tij në fund të periudhës 31 Dhjetor 2019, janë :

Numeri i Aksioneve	Vlera nominale e aksionit	Aksioner :	Struktura Kapitalit	Kapitali aksionar - ne leke
3,500	1,000	OSHEE GROUP	100%	3,500,000

4. Vlerësimet kritike dhe gjykimet e kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet bëhen në vazhdimësi dhe bazohen në përvoja historike, duke përfshirë ngjarje të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësimet dhe supozimet lidhur me të ardhmen. Vlerësimet e kontabilitetit do të rezultojnë, sipas rastit, pothuajse të barabarta me rezultatet aktuale.

Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një rrezik të konsiderueshëm dhe mund të shkaktojnë një rregullim material në vlerat e aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë diskutuar më poshtë:

4.1 Vlerësime dhe supozime kritike kontabël

(a) Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Vlera e drejtë e instrumentave financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (për shembull, hua të marra ose të dhëna punonjësve) përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të zgjedhur një numër metodash dhe bën supozime që bazohen kryesisht në kushtet e tregut në çdo datë bilanci. Shoqëria përdor metodën e skontimit të fluksit të mjeteve monetare për aktive dhe detyrime financiare që nuk tregtohen në tregje aktive.

(b) Aktivët afatgjatë materiale

Drejtimi i shoqërisë përcakton jetën e dobishme të pritur të përdorimit dhe normat e zhvlerësimit, në lidhje me aktivët afatgjatë që ka në zotërim. Ky vlerësim bazohet në ciklet e përcaktuara të jetës së aktivit. Kjo mund të ndryshojë në varësi të ndryshimeve të mundshme në treg. Ndryshimet e mundshme në jetëgjatësinë e përdorimit të aktivit mund të çojnë në axhustime të vlerës së tyre neto.

(c) Rënie në vlerë e aktiveve financiare (hua dhe llogari të Arkëtueshme)

Shoqëria ndjek udhëzimet e SNK-ve për të përcaktuar se kur një aktiv financiar ka pësuar rënie në vlerë. Ky përcaktim kërkon gjykim të thellë. Gjatë kryerjes së këtyre gjykimeve, Shoqëria vlerëson, veç faktorëve të tjerë, kohëzgjatjen dhe shtrirjen gjatë të cilës vlera e drejtë e një investimi, është më e vogël se kostoja e tij dhe flukset e veta të mjeteve monetare.

Rigjykimi i rënies në vlerë, të llogarive të Arkëtueshme në vitin pasardhës, mund të çojnë në korigjime të vlerës së mbartur të llogarisë së arkëtueshme.

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

4.2 Gjykimet në lidhje me Parimin e vijimësisë

Pasqyrat financiare të vitit 2019 janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e OSSH do të ketë vijimësi, në përputhje me përshkrimet e zbatimit të këtij parimi në Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) Nr.1 Paragrafi 25.

Siguria në vijimësinë e aktivitetit të shoqërisë në vazhdim mbështetet në:

a. Pozita e favorshme në tregun e energjisë.

OSSH do të jetë në pozitë të favorshme në tregun e energjisë, pozitë e cila për periudhën në vazhdim sanksionohet edhe në ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” datë 30.04.2015, i cili parashikon vazhdimin e aktivitetit të Operatorit aksionet e të cilit zotërohen tërësisht nga shteti dhe për të cilin nuk ka plane afatshkurtëra dhe afatmesme privatizimi.

Kështu OSSH si pjesë e shoqërisë OSHEE, do të trashëgojë infrastrukturën dhe përvojën shumëvjeçare të biznesit të shoqërisë mëmë, duke patur kështu pozita të favorshme në aktivitetin tregtar.

b. Mbështetja e Qeverisë

Qeveria ka aprovuar Planin për Rimëkëmbjen Financiare në Sektorin e Energjisë, me synimin për të përmirësuar arkëtimet, flukset monetare, pakësuar humbjet dhe siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji në mënyrë që të arrihet qëndrueshmëria dhe të rikthehet besimi në sektorin energjetik. Qeveria është angazhuar për të siguruar bashkëpunimin e të gjithë ministrive dhe institucioneve publike për implementimin e planit.

Dhënia e nënhuave nga ana e qeverisë për kryerje të investimive në rrjetin shpërndarës dhe në sistemin e matjes së energjisë, është mbështetje kryesore në përmirësimin e treguesve cilësorë të shpërndarjes së energjisë dhe të matjes së saj në shitje për klientët.

Po kështu, mbështetja nga institucionet shtetërore, vërehet edhe nga vendimet e ERE për licensimin e shoqërisë dhe për periudhën e futjes në aktivitetin tregtar.

c. Masa të tjera

Shoqëria “Mëmë” OSHEE GROUP do të vazhdojë të mbështesë shoqërinë në këtë periudhë fillestare të ushtrimit të aktivitetit deri në forcimin e saj dhe të krijimit të kushteve të favorshme për të vazhduar një aktivitet normal e të pavarur ekonomikisht nga Grupi.

Në përfundim:

Vijimësia e aktivitetit të Shoqërisë OSSH sha, për rëndësinë që ajo ka në kryerjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sidomos për klientët fundor të energjisë, si detyrim i shërbimit publik, por edhe bazuar në masat e marra nga Administrimi e në veçanti nga Qeveria, garantojnë vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë.

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

Shënime për veprimet në periudhën raportuese

Më poshtë janë shpjegimet për veprimet e kryera në periudhën raportuese dhe balancat më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018.

5. Aktivet afatgjata (materiale, jomateriale dhe financiare)

Shoqëria nuk ka evidentuar gjatë periudhës raportuese aktive afatgjata materiale, aktiva materiale jomateriale dhe aktive financiare. Balanca në fund të periudhës është zero.

6. Tatimi i shtyrë

Shoqëria nuk ka të evidentuar tatim të shtyrë në periudhën raportuese.

7. Aktivet Afatshkurtra

a. *Për Inventarët, Të arkëtueshme tregtare e tjera*, Shoqëria në periudhën raportuese nuk ka rregjistrime.

b. *Mjete monetare*, më 31 Dhjetor 2019, janë në balancën si më poshtë :

Përshkrimi llogarisë	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Llogari bankare rrejdhëse	1,925,931	961,123
Mjete monetare në Arkë	0	0
Para në Tranzit	0	0
Totali	1,925,931	961,123

Nga vlera e transferuar në llogarinë e shoqërisë, nga shoqëria mëmë për emetim kapitali, janë paguar pagat e kontributet e sigurimeve shoqërore e shendetësore të administratorit, pagesat e këshillit të administrimit, tarifat e licensimit e taksa lokale.

8. Kapitali aksionar

Me Urdhërin e Ministrit të MIE nr.157 dt.12.2.2018 është vendosur, që me krijimin e shoqërisë të krijohet edhe kapitali themeltar në vlerën 3,500,000 lekë, vlerë e cila është emetuar (transferuar) nga shoqëria mëmë - OSHEE ShA.

Lëvizja e kapitalit në periudhën raportuese është si tabela më poshtë :

Kapitali dhe Rezervat	Balanca Më 31.12.18	Shtesa	Paksime	Balanca Më 31.12.2019
Kapitali aksionar	3,500,000	0	-	3,500,000
Rezerva te tjera	-	-	-	-
Te ardhura neto vjetore	(3,033,154)	-	(3,956,516)	(6,989,670))

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

Parapagimet per TF	-	-	-	-
Kapitali total	466,846	-	(3,956,516)	(3,489,670)

Në kushtet e mosgjenerimit të të ardhurave gjatë periudhës raportuese, shoqëria ka rezultuar me humbje për pjesën e shpenzimeve minimale të kryera, verë e cila ka dhënë efekt në uljen e vlerës së kapitalit në mbyllje të periudhës raportuese më 31 Dhjetor 2019.

9. Detyrimet Afatgjata

Shoqëria nuk ka detyrime afatgjata në fund të periudhës raportuese.

10. Detyrimet Afatshkurtra

a. *Llogaritë e pagueshme.* Shoqëria nuk ka detyrime të evidentuara në llogaritë e pagueshme, pasi gjatë periudhës raportuese, nuk janë bërë blerje e furnizme nga furnitorë.

b. Detyrime për Taksa dhe Sigurime shoqërore.

Një tabelë e detyrimeve në fund të periudhës raportuese '2019 dhe '2018, është :

Detyrimi	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	34,895	32,733
Tatimi mbi të ardhurat personale	27,100	75,100
TVSH e pagueshme neto	(44,000)	0
Shteti Tatim Taksa	0	0
Të tjera (Tatim në Burim)	11,250	11,250
Totali	29,245	119,083

Balanca e detyrimeve si më sipër, i përket detyrimeve koherente të deklaruara në muajin e fundit të periudhës raportuese dhe të paguara në muajin Janar 2019.

c. *Detyrimet e Huave Afatshkurta.* Shoqëria nuk ka detyrime të evidentuara në llogaritë e Pjesës afatshkurta dhe të Huave afatshkurta.

11. Detyrime të tjera afatshkurtra

Detyrime të tjera afatshkurtra lidhen me paga të pagueshme personelit e te tjera , sipas ndarjes së mëposhtme :

Detyrimi	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Paga të pagueshme	376,356	375,194
Detyrime brenda Grupit	5,000,000	
Kreditorë të tjerë	10,000	0
Shpenzime të llogaritura	0	0
Total	5,386,356	375,194

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

Detyrimi për pagat, i përket pagës neto për tu paguar për muajit e fundit të periudhës.

Detyrimi brenda grupit i përket fondeve të kaluara shoqërisë nga shoqëria “Mëmë”, për të mbuluar pagesat më të domosdoshme gjatë periudhës.

Vlera tek “kreditore” i përket detyrimit ndaj punonjesve ndaluar gabimisht nga paga.

Shoqëria nuk ka evidentuar provizione.

12. Të Ardhurat operative

Shoqëria në periudhën raportuese nuk ka kryer aktivitet tregtar dhe respektivisht nuk ka bërë shitje.

Treguesi i të ardhurave për periudhën raportuese është zero.

13 Shpenzimet operative

a. Lende e pare dhe materiale konsumi.

Gjatë vitit nuk ka patur shpenzime materiale. Në fund të periudhës, muajin Dhjetor, janë blerë blloqe fature tatimore për fillimin e aktivitetin në periudhën e ardhshme

Pasqyrimi i këtyre tregueve është si më poshtë :

Përshkrimi	Në vitin 2019	Në vitin 2018
Karburante dhe lende te tjera djegese	0	0
Shpenzime operative(materiale)	0	0
Shpenzime operative kancellerie	84,000	0
Shpenzime operative materiale te tjera	0	0
Totali	84,000	0

b. *Shpenzimet e personelit.* Shoqëria gjatë periudhës raportuese, ka patur të punësuar vetëm administratorin. Gjithashtu janë bërë shpenzime edhe për pagesat e këshillit të administrimit.

	2019		2018	
	Total	Nga Totali-Stafi Menaxh.	Total	Nga Totali-Stafi Menaxh.
Shpenzimet/Llogaritë				
Paga bazë	3,174,000	900,000	2,684,524	675,000
Kompensime të tjera	126,000	0	0	0
Kontributet Sig shoq&Shend	247,212		175,093	
Totali	3,547,212	900,000	2,859,617	675,000

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

c. *Shpenzime të tjera.* Në këtë grup shpenzimesh janë evidentuar shpenzimet e tjera të bera veç atyre të lidhura me personelin, konkretisht si më poshtë :

Shërbimi	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Posta dhe telefoni	0	0
Qera	0	0
Shërbime konsulense/auditimi	195,000	
Gjoha e penalitete	2,224	0
Të tjera	128,144	0
Totali	325,368	0

Në shpenzimet e tjera, janë evidentuar pagesat për taksa e tarifa vendore vlera 92,000 lekë dhe komisionet bankare për transferimet e bëra vlera 36,44 lekë.

14. Shpenzimet financiare neto

Për këto llogari shoqëria ka të evidentuar vlerat si më poshtë :

	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Shpenzime Interesi	0	0
Të ardhura nga depozitat bankare	64	1,599
Të tjera shpenzime financiare	0	0
Rezultati neto -diferencat e k.k	0	0
Totali	64	1,599

Vlera e evidentuar i përket të ardhurave nga interesat e gjendjeve në llogarinë rrjedhëse në bankë.

15. Informacion mbi Palët e lidhura

Duke qenë shoqëri me kapital 100% shtetëror, marrëdhëniet me palët e lidhura përfshijnë aktivet dhe detyrimet që lidhen me shoqëritë me kapital shtetëror dhe institucionet buxhetore.

Përshkrimi	Më 31.12.2019	Më 31.12.2018
1 Të arkëtueshme nga klientë	0	0
2 Të pagueshme të tjera	0	0
Totali Aktiveve	0	0
1 Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	34,895	32,733
2 Tatimi mbi të ardhurat personale	27,100	75,100
3 Tatimi në burim	11,250	11,250
4 TVSH	(44,000)	0
5 Të pagueshmet për taksën TV	0	0
Totali Detyrimeve tatimore	29,245	119,083
Detyrime ndaj grupit	5,000,000	0
1 Të ardhura	0	0
Totali të Ardhurave	0	0

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

1	Shpenzime	0	0
	Totali i Shpenzimeve	0	0

16. Llogaritja e Tatimit mbi Fitimin

Përbërësit e Tatimit mbi Fitimin të përlllogaritur janë si më poshtë:

Tatimi mbi Fitimin	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Tatimi mbi fitimin e llogaritur	0	0
Tatimi i shtyrë	0	0
Totali	0	0

Llogaritje :	Ushtrimore 2019	Tatimore 2019
Të Ardhurat	0	0
Shpenzimet	(3,956,516)	(3,945,516)
Të panjohura		2,224
Fitim / (Humbja)	(3,956,516)	(3,954,293)
Tatim Fitimi (15%)		0
Tatim Fitimi Parapagime		0
Tatim Fitimi për tu paguar		0

Në shpenzimet e panjohura është evidentuar gjoba e paguar për taksat vendore vlera 2,224 lekë.

17. Menaxhimi i kapitalit

Një nga qëllimet kryesore të Shoqërisë mbetet ruajtja e një prirjeje pozitive dhe për të përmirësuar përfitimet e Shoqërisë, jo vetëm për mbështetjen e planeve të investimeve, por edhe për konsolidimin e mëtejshëm dhe stabilizimin e strukturës së kapitalit në vitet në vijim.

Të dhënat për strukturën e Kapitalit në fund të vitit tatimor 2019, janë :

	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Totali i borxhit afatgjatë	0	0
Totali i huasë afatashkurtër	0	0
Totali i borxhit	0	0
Më Pak: Aktive Monetare	(1,925,931)	(961,123)
Totali i borxhit, neto	(1,925,931)	(961,123)
Humbja përpara tatimit mbi fitimin dhe të ardhurave të tjera (Shpenzime)	(3,034,754)	(3,034,754)
Plus: Zhvlerësimi dhe amortizimi	0	0
Humbja para Interesave, tatimit mbi fitimin, zhvlerësimit dhe amortizimit	(3,956,580)	(3,034,754)
Kapitali Aksioner total	(3,489,670)	466,846

OSHEE SH.A
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

Borxhi total	0	0
Kapitali total	(3,489,670)	466,846
Raporti Borxhi/Kapital	0	0

18. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara

Shoqëria nuk ka as angazhime dhe as detyrime të kushtëzuara në fund të periudhës raportuese.

Me kalimin në ushtrimin e aktivitetit si subjekt i veçantë juridik, në fillim të periudhës 2020, referuar vendimit të Aksionarit datë 24 Dhjetor 2019, Shoqëria duhet të mbartë të gjitha të drejtat operationale si dhe të mbartë të drejtat dhe detyrimet kontraktore që lidhen me veprimet/operationet e biznesit sipas licensimit.

Procesi i evidentimit të drejtave dhe detyrimeve të trashëguara nga shoqëria mëmë do vazhdojë deri në fund të gjashtëmujorit të parë 2020.

19. Ngjarje pas datës së bilancit

Ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat nuk bëhen rregullime, nuk ka.